- **Termat dhe Kushtet** (referuar gjithashtu edhe si "Kushtet") nënkuptojnë Kushtet që përbëjnë marrëveshjen në tërësi ndërmjet Jush dhe Shoqërisë përsa i takon shfrytëzimit të Shërbimit.
- **Shërbimofruesit ose Shërbimi i Mediave Sociale Palë të Treta** nënkupton çdo shërbim apo përmbajtje (duke përfshirë të dhëna, informacion, produkte apo shërbime) të ofruara nga një palë e tretë që mund të shfaqen, përfshihen ose bëhen të disponueshme nga Shërbimi.
- **Faqe Interneti** i referohet Faqes së Internetit të South Outdoor Festival, e aksesueshme në adresën <http://www.southoutdoor.al>
- **Ju** nënkupton personin që futet ose përdor Shërbimin, ose shoqëria, apo ndonjë person juridik tjetër në emër të të cilit një person i tillë futet apo përdor Shërbimin, sipas rastit.

Ndërgjegjësim

Këto janë Kushtet që rregullojnë përdorimin e këtij Shërbimi dhe marrëveshja që rregullon marrëdhënien ndërmjet jush dhe shoqërisë. Këto kushte përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e të gjithë përdoruesve për përdorimin e Shërbimit.

Hyrja juaj në Shërbim dhe përdorimi i tij kushtëzohet nga pranimi dhe respektimi i këtyre Kushteve nga ju. Këto Kushte zbatohen për të gjithë vizitorët, përdoruesit dhe të tjerët që hyjnë apo përdorin Shërbimin.

Duke hyrë ose duke përdorur Shërbimin Ju pranoni të respektoni këto Kushte. Nëse nuk jeni dakord me ndonjë pjesë të këtyre kushteve, atëherë nuk mund të hyni në Shërbim.

Duke hyrë ose duke përdorur Shërbimin Ju deklaroni se jeni të paktën 18 vjeç.

Hyrja në dhe përdorimi i Shërbimit prej Jush kushtëzohet gjithashtu nga pranimi dhe respektimi nga Ju i Politikës së Privatësisë së Kompanisë. Politika jonë e privatësisë përshkruan politikat dhe procedurat tona për mbledhjen, përdorimin dhe zbulimin e informacionit Tuaj personal kur përdorni Aplikacionin ose Faqen e Internetit dhe Ju informon për të drejtat Tuaja të privatësisë dhe mënyrën se si Ju mbron ligji. Ju lutemi lexojeni me kujdes politikën Tonë të privatësisë përpara se të përdorni Shërbimin.

Platforma Ndërmjetëse e SOFW dhe Roli Ndërmjetës i Shoqërisë

Duke hyrë apo duke përdorur Shërbimin, Ju kuptoni dhe bini dakord se Platforma e Rezervimeve të South Outdoor Festival dhe/ose Shoqëria i referohet një Platforme ndërmjetëse dhe/ose Pale ndërmjetëse që iu ofron turistëve/vizitorëve një shërbim online nëpërmjet Internetit dhe aplikacioneve. Aktivitetet/shërbimet/mallrat ofrohen nga nja sërë Shërbimofruesish profesionistë vendas me aktivitet në Shqipëri dhe që bashkëpunojnë me South Outdoor Festival në bazë të një marrëveshjeje shërbimi për aktivitetet përkatëse. Shërbimet e ofruara nga Shërbimofruesit mund të aksesohen nëpërmjet Platformës së Rezervimeve SOF, ku mund të bëhen rezervimet/porositë. Platforma e Rezervimeve SOF vepron si ndërmjetës që lidh vizitorët/Ju me Shërbimofruesit palë të treta. South Outdoor Festival autorizohet të arkëtojë shumat e faturuara në emër dhe për llogari të Shërbimofruesve.

Shoqëria nuk është përgjegjëse për lëvrimin e Mallrave. Të gjitha përgjegjësitë për lëvrimin e Mallrave i takojnë Shërbimofruesve. Me anë të hyrjes në dhe përdorimit të Shërbimit Ju kuptoni dhe bini dakord se nuk do të ngrihet asnjë pretendim ligjor dhe/ose financiar përsa i takon Mallrave të lëvruara nga Shërbimofruesit ose në përputhje me Mallrat e lëvruara nga Shërbimofruesit kundrejt Shoqërisë dhe pretendime të tilla mund t'i bëhet direkt Shërbimofruesve. Shoqëria nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi përsa i takon pretendimeve nga Ju/vizitorët në lidhje me Mallrat e lëvruara nga Shërbimofruesit.

Bërja e Porosive/Rezervimi për Mallra

Duke bërë një Porosi për Mallra nëpërmjet Shërbimit, Ju garantoni se jeni ligjërisht në gjendje të lidhni kontrata me detyrime dhe se jeni të paktën minimalisht në moshën 18 vjeç.

Informacioni/Privatësia Juaj

Nëse dëshironi të bëni një Porosi për Mallrat e disponueshme të Shërbimit, do t'ju kërkohet të jepni disa të dhëna të rëndësishme për Porosinë tuaj, duke përfshirë, pa kufizim, emrin dhe mbiemrin tuaj, adresën tuaj të postës elektronike, numrin e telefonit / celularit dhe Vendin tuaj të origjinës dhe / ose vendin nga ku po bëni porosinë, numrin e kartës suaj të kreditit, datën e skadimit të kartës së kreditit, adresën tuaj të faturimit dhe / ose informacionin e transportit.

Ju deklaroni dhe garantoni se: (i) keni të drejtën ligjore të përdorni çdo kartë krediti ose debiti ose mënyra të tjera të pagese për çdo porosi; dhe se (ii) informacioni që na jepni është i vërtetë, i saktë dhe i plotë.

Që këtu e tutje, të gjitha këto informacione do t'i trajtojmë si rreptësisht private dhe konfidenciale dhe do të ndërmarim të gjitha hapat e nevojshëm për të ruajtur konfidencialitetin e tyre. Nuk do të përdorim, kopjojmë ose ruajmë ndonjë informacion të tillë në një kompjuter të jashtëm të aksesueshëm ose një sistem të ngjashëm, as do ta transmetojmë atë brenda ose përmes ndonjë sistemi të tillë. Do ta përdorim një informacion të tillë për qëllimin e lejuar dhe për asnjë qëllim tjetër dhe veçanërisht, por pa kufizime, nuk do të përdorim asnjë informacion të tillë në mënyrë që të sigurojmë ndonjë avantazh tregtar mbi kompaninë.

Me dorëzimin e një informacioni të tillë, Ju na jepni të drejtën për të dhënë informacionin tek palët e treta për përpunimin e pagesave për qëllime të lehtësimit të përmbushjes së Porosisë tuaj. Do të lejojmë t'i zbulojmë këto informacione tek palët e treta/punonjësit përgjegjës për kryerjen e pagesave dhe për ata këshilltarë ligjorë dhe financiarë, për të cilët në secilin rast zbulimi është i duhur dhe i nevojshëm për qëllimin e lejuar. Do të sigurojmë që personat që marrin informacionin dhe çdo person tjetër, të cilit i është bërë një zbulim i tillë, t'i përmbahen kushteve të këtij dokumenti sikur të ishin palë.

Do të mbajmë një evidencë të informacionit që na është dhënë dhe personave të tjerë dhe vendndodhjen e një informacioni të tillë dhe të çdo personi që disponon një informacion të tillë.

Konfirmimi i Porosisë/Rezervimit

Do të merrni një email dhe kupon konfirmimi menjëherë pasi të keni bërë porosinë/rezervimin.

Do të merrni mesazhe të ndryshme në postën elektronike apo telefonata nga ne, për informacione të rëndësishme dhe të dobishme që lidhen me rezervimin/porosinë tuaj.

Në rast se nuk do t'ju vijë email nga ne, ju lutemi të kontrolloni folderin SPAM ose të na njoftoni me email.

Anulimi i Porosisë/Rezervimit

Ne rezervojmë të drejtën të refuzojmë ose të anulojmë Porosinë Tuaj në çdo kohë për disa arsye duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- Disponueshmërinë e Mallrave;
- Gabimet në përshkrimin ose çmimet e Mallrave;
- Gabime në Porosinë Tuaj;
- Shkaqe të tjera të arsyeshme.

Rezervojmë të drejtën e refuzimit ose anulimit të Porosisë Tuaj nëse dyshojmë për mashtrim apo transaksione të paligjshme ose të paautorizuara.

Të Drejtat e Anulimit të Porosisë/Rezervimit Tuaj

Mallrat dhe Shërbimet që do të blihen mund të kthehen / anulohen vetëm në përputhje me këto Kushte. Ju lutemi i lexoni këto Kushte për të mësuar më shumë rreth të drejtës suaj për anulimin e porosisë / prenotimit tuaj.

Pavarësisht nga ndonjë arsye apo shkak, anulimet e rezervimeve sjellin kosto dhe shpenzime të konsiderueshme për Ne dhe Shërbimofruesit tanë, ofruesit e hoteleve dhe transportit që mbulojnë gjokat dhe tarifatat e rezultuara nga anulimet e prenotimeve/porosive të konfirmuara. Për rrjedhojë, për anulimet do të aplikohen gjokat dhe tarifatat e mëposhtme.

Në asnjë rrethanë nuk mund të rimbursohen pagesat e bëra për biletat e hyrjes në SOF.

Përveç biletave të hyrjes në SOF, rimbursimet e pagesave përfundimtare të marra nga Ju për porositë/rezervimet për aktivitetet dhe turet do të bëhen si më poshtë:

- Kur anulimi i porosisë kërkohet më shumë se 60 ditë para fillimit të shërbimit/aktivitetit të planifikuar: **Rimbursimi I bëhet i plotë** (gjithsesi "Tarifa e Shërbimit" prej 5% është e parimbursueshme).
- Kur anulimi i porosisë kërkohet ndërmjet 30-60 ditëve deri në përpara fillimit të shërbimit/aktivitetit të planifikuar: **bëhet 50% rimbursim i shumës totale të çmimit të paguar për porosinë / rezervimin;**
- Kur anulimi i porosisë kërkohet 30 ditë ose më pak përpara fillimit të shërbimit/aktivitetit të planifikuar: **Nuk ka rimbursim.**

Në rast të një moti shumë të keq, ose për shkak të mungesës së paparashikuar të stafit të duhur, ne mund të anulojmë një shërbim/ aktivitet për sigurinë tuaj. Në këtë rast do të kryhet rimbursim i plotë (përfshirë tarifën e shërbimit nëse ka) për rezervimin tuaj dhe ne do të bëjmë gjithçka në autoritetin tonë për t'ju ndihmuar të gjeni një aktivitet tjetër të përshtatshëm.

Për Mallrat: E drejta juaj për të anuluar një Porosi zbatohet vetëm për Mallrat që janë kthyer në të njëjtën gjendje që i morët nga ne. Duhet gjithashtu të përfshini të gjitha udhëzimet e produkteve, dokumentacionin dhe ambalazhimin. Nuk do të rimbursohen Mallrat që janë dëmtuar ose jo në të njëjtën gjendje që i morët ose që janë konsumuar përtej hapjes së ambalazhimit origjinal. Prandaj, duhet të tregoni kujdes të arsyeshëm për Mallrat e blera ndërkohë që janë dhe nëse janë në zotërimin tuaj.

Nëse do të bëhet rimbursim, atëherë ai bëhet në përputhje me të gjitha procedurat dhe realizohet sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe shuma e parashikuar do të transferohet tek e njëjta kartë krediti që është përdorur gjatë rezervimit. Ju lutemi vini re se nuk mund të jemi përgjegjës për vonesat e dorëzimit të rimbursimit në llogarinë tuaj pasi të jetë bërë dërgesa nga ana jonë.

Nëse do të bëhet rimbursim, ne do t'ju rimbursojmë jo më vonë se 30 ditë nga dita në të cilën morëm njoftimin për anulimin e porosisë tuaj. Do të përdorim të njëjtat mjete pagese që përdorët ju për Porosinë, dhe ju nuk do të paguani asnjë tarifë për këtë rimbursim.

Ju nuk do të keni të drejtë të anuloni një Porosi për lëvrimin e asnjë prej Mallrave të mëposhtëm:

- Furnizimin me Mallra të bëra sipas specifikimeve tuaja ose dukshëm të personalizuar;
- Furnizimi me Mallra që sipas natyrës së tyre nuk janë të përshtatshme për t'u kthyer, prishen shpejt ose kur ka kaluar data e skadimit;
- Furnizimi me Mallra që nuk janë të përshtatshme për t'u kthyer për shkak të mbrojtjes së shëndetit apo arsyeve higjienike dhe që janë të hapura pas dorëzimit;
- Furnizimi me Mallra që, pas dorëzimit, për shkak të natyrës së tyre, përzihen në mënyrë të pandashme me artikuj të tjerë;
- Furnizimi me artikuj digjital që nuk lëvrohen me mjete të prekshme nëse veprimet kanë filluar me pëlqimin tuaj paraprak dhe Ju e keni pranuar humbjen nga ana juaj të të drejtës së anulimit;
- Biletat e hyrjes në SOF.

Disponueshmëria, Gabimet dhe Pasaktësitë

Ne vazhdimisht i përditësojmë ofertat tona të Mallrave në Shërbim. Mallrat e disponueshëm në Shërbimin tonë mund të jenë me çmime të gabuara, të përshkruara në mënyrë të pasaktë, ose të padisponueshme, dhe mund të kemi vonesa në përditësimin e informacionit në lidhje me Mallrat tona në Shërbim dhe në reklamat tona në faqet e tjera të internetit.

Ne nuk mund dhe nuk garantojmë saktësinë ose plotësinë e çdo informacioni, përfshirë çmimet, imazhet e produkteve, specifikimet, disponueshmërinë dhe shërbimet. Ne rezervojmë të drejtën të ndryshojmë ose përditësojmë informacionin dhe të korrigjojmë gabimet, pasaktësitë, ose mosveprimet në çdo kohë pa njoftim paraprak.

Politika e Çmimeve

Shoqëria rezervon të drejtën të rishikojë çmimet e saj në çdo kohë përpara se të pranojë një porosi. Çmimet e cituara mund të rishikohen nga Shoqëria pas pranimit

të një Porosie në rast të ndonjë ngjarjeje që ndikon në dorëzimin e mallrave/shërbimeve e shkaktuar nga veprimet e qeverisë, ndryshimet në detyrimet doganore, rritja e tarifave të transportit, kostot më të larta të këmbimit valutor dhe çdo çështje tjetër përtej kontrollit të Shoqërisë. Në atë rast, Ju nuk do të keni të drejtë të anuloni Porosinë Tuaj.

Pagesat

Të gjitha mallrat/shërbimet e blera i nënshtrohen një pagese të vetme. Pagesa mund të bëhet me mënyra pagese të ndryshme që kemi në dispozicion, si p.sh. Kartat Visa, MasterCard, Affinity Card, kartat American Express ose mënyrat e pagesës në internet (për shembull PayPal). Është e rëndësishme të siguroheni që të përdorni emrin dhe adresën siç i është dhënë bankës tuaj sepse herë pas here pagesat nuk bëhen si duhet për shkak të humbjes ose pasaktësisë së informacionit. Në këtë rast, Ne nuk do të jemi përgjegjës për ndonjë vonesë ose mos-dorëzim të Porosisë / Rezervimit Tuaj. Kartat e pagesave (kartat e kreditit ose kartat e debitit) i nënshtrohen kontrolleve të vlefshmërisë dhe autorizimit nga emetuesi i kartës suaj. Nëse nuk marrim autorizimin e kërkuar, nuk do të jemi përgjegjës për ndonjë vonesë ose mos-dorëzim të Porosisë / Rezervimit Tuaj.

Garancia e Çmimit më të Mirë

Eventi South Outdoor Festival synon të ofrojë Mallra/Shërbime me çmimin më të mirë të mundshëm. Nëse përdoruesi e gjen ofertën që ka rezervuar nëpërmjet South Outdoor Festival me të njëjtat kushte por me një çmim më të ulët në internet (qytet/fshat, numri i njerëzve, disponueshmëria), South Outdoor Festival do t'i paguajë përdoruesit, vullnetarisht, diferencën midis çmimit të paguar dhe çmimit më të ulët që gjendet në internet.

Si të përdorni Faturën tuaj

Ju mund ta paraqisni Konfirmimin e Rezervimit (faturë) ose të printuar ose në telefonin celular për aktivitetin e zgjedhur në SOF. Fatura është e vlefshme deri më 3 maj 2020, ora 06:00 P.M. Ju duhet të regjistroheni dhe të merrni shiritin e dorës në ditën kur do të vini në SOF. Kjo do të lehtësojë udhëtimin tuaj gjatë gjithë qëndrimit përgjatë Festivalit. Gjithashtu mund të futeni në event direkt me anë të faturës.

Biletat e patransferueshme të Hyrjes në SOF

Biletat e hyrjes në SOF nuk janë të transferueshme tek palë të treta pas blerjes nga Shoqëria. Shoqëria ka të drejtën të refuzojë hyrjen në SOF nëse biletat e hyrjes e ofruara për shitje i transferohen palëve të treta.

Mbërritja në Pikën e Takimit dhe Respektimi i Kushteve

Ju jeni përgjegjës për mbërritjen me kohë në pikën e njoftuar të takimit për SOF. Nëse vini nga jashtë shtetit, jeni përgjegjës për të pasur dokumentacionin e nevojshëm të udhëtimit (pasaportën, etj.) dhe për respektimin e të gjitha masave paraprake shëndetësore dhe rregulloreve të kërkuara, etj.

Ju jeni përgjegjësi i vetëm për fëmijët nga mosha 0 deri në 18 vjeç që i sillni në SOF. Shoqëria dhe organizatorët e SOF nuk kanë dhe nuk do të kenë asnjë përgjegjësi ligjore dhe / ose financiare për fëmijët nga mosha 0 deri në 18 vjeç që ju sillni në SOF.

Pronësia Intelktuale/Pronësia e Përmbajtjes

Shërbimi dhe përmbajtja e tij origjinale (duke përjashtuar Përmbajtjen e dhënë nga Ju ose përdoruesit e tjerë), veçoritë dhe funksionaliteti janë dhe do të mbeten pronë ekskluzive e Shoqërisë dhe licencuesve të saj.

Shërbimi mbrohet nga të drejtat e autorit, marka tregtare dhe ligjet e tjera vendase dhe të vendeve të huaja. Në veçanti, të gjitha tekstet, titujt e faqeve, dokumentacioni teknik, imazhet, fotografitë, modelet, grafikat, logot, ikonat e butonave, skriptet, emrat e shërbimeve, të dhënat e produktit, ndërfaqet vizuale, markat tregtare, tingujt, muzika, videot, përmbajtja e transmetimit, programet kompjuterike dhe punimet artistike, duke përfshirë por pa u kufizuar në modelin, strukturën, përzgjedhjen, koordinimin, shprehjen që përmbahet në Shërbim është në pronësi ose kontrollohet nga Ne, ose është e licencuar nga Ne, dhe mbrohet nga legjislacioni për të drejtave të autorit, patentat dhe markat tregtare si dhe të drejtat e ndryshme të pronësisë intelektuale dhe ligjet e konkurrencës.

Markat dhe veshja jonë tregtare nuk mund të përdoren në lidhje me ndonjë produkt ose shërbim pa pëlqimin paraprak me shkrim të Shoqërisë.

Të gjitha markat e tjera tregtare që nuk janë në pronësinë tonë që shfaqen në Shërbim janë pronë e pronarëve të tyre përkatës, të cilët mund ose nuk mund të jenë filial i yni, të lidhur ose të sponsorizuar nga Ne. Ne mund të ndryshojmë përmbajtjen dhe karakteristikat e Shërbimit në çdo kohë. Ju nuk mund të kopjoni, përdorni, ribotoni, shkarkoni, postoni, ekspozoni publikisht, transmetoni, riprodhoni ose shpërndani në çfarëdo mënyre përmbajtjen (ose ndonjë pjesë të saj) në çfarëdo mënyre pa lejen tonë paraprake me shkrim, përveç nëse lejohet shprehimisht nga Kushtet. Është rreptësisht e ndaluar çdo përpjekje e paautorizuar për të kopjuar ose modifikuar përmbajtjen, ose për të anashkaluar ose eliminuar ndonjë nga karakteristikat e sigurisë të krijuara për të mbrojtur përmbajtjen.

Komentet Tuaja për Ne/Fotografitë, Imazhet dhe Regjistrimet Audiovizuale

Komentet për Ne

Ju i transferoni të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat për çdo Koment që i dërgoni Shoqërisë. Nëse për ndonjë arsye një transferim i tillë është i paefektshëm, Ju bini dakord t'i jepni Shoqërisë një të drejtë globale, pa pagesë, të përvokueshme, të vazhdueshme dhe jo ekskluzive, dhe licencën për prodhimin, riprodhimin, zbulimin, nën-licencimin, shpërndarjen, modifikimin dhe shfrytëzimin e Komenteve të tilla pa kufizim.

Fotografitë, Imazhet dhe Regjistrimet Audiovizive

Ne bëjmë rregullisht fotografi dhe video për qëllime promociionale dhe trajnimi dhe herë pas here marrim kërkesa nga media televizive apo shoqëri të tjera për të realizuar filmime/fotografime në vende të caktuara. Duhet të dini se gjatë eventit apo gjatë aktiviteteve ku do të merrni pjesë, mund të jenë duke u realizuar filmime. Duke marrë pjesë në South Outdoor Festival (dhe në aktivitetet e ofruara nga ne), ju pranoni të filmoheni / regjistroheni në video dhe/ose të fotografoheni, dhe pranoni t'i jepni Shoqërisë një të drejtë globale, pa pagesë, të përvokueshme, të vazhdueshme dhe jo ekskluzive, dhe licencën për përdorimin, riprodhimin, zbulimin, nën-licencimin, shpërndarjen, modifikimin dhe shfrytëzimin e këtyre fotografive, imazheve, videove dhe regjistrimeve audiovizuale pa kufizime. Ju i jepni prodhuesve të Festivalit lejen të përdorin imazhin, zërin dhe pamjen tuaj për qëllime promovimi dhe trajnimi. Çdo punim artistik apo performancë që përmban foton, imazhin, videon apo regjistrimin tuaj audioviziv sponsorizuar nga Festivali apo që realizohet në ambientet e Festivalit i nënshtrohet gjithashtu të drejtës globale, pa pagesa, të pakthyeshme, të vazhdueshme dhe jo-ekskluzive dhe

licencës për përdorimin, riprodhimin, zbulimin, nën-licencimin, shpërndarjen, modifikimin dhe shfrytëzimin pa kufizim tek prodhuesit e Festivalit për tu përdorur për qëllime trajnimi dhe promovimi të Festivalit.

Lidhjet me Faqet e tjera të Internetit

Shërbimi ynë mund të përmbajë lidhje me faqe Interneti të palëve të treta ose shërbime që nuk janë në pronësi ose kontrollohen nga Shoqëria.

Shoqëria nuk ka asnjë kontroll mbi dhe nuk mban asnjë përgjegjësi për përmbajtjen, politikat e privatësisë ose praktikën e ndonjë faqe interneti ose shërbime të palëve të treta. Në vijim ju pranoni dhe bini dakord që Kompania nuk do të jetë përgjegjëse civilisht apo penalisht, direkt ose indirekt, për ndonjë dëmim ose humbje të shkaktuar ose të pretenduar të jetë shkaktuar nga ose në lidhje me përdorimin ose mbështetjen në çdo përmbajtje, mallra ose shërbime të tilla të disponueshme në ose nëpërmjet cilësdo faqe interneti ose shërbimesh të tilla.

Ne ju këshillojmë fort që të lexoni kushtet dhe politikat e privatësisë të të gjitha faqeve të internetit ose shërbimeve të palëve të treta që vizitoni.

Mbarimi i të Drejtës së Shërbimit

Ne mund të ndalojmë ose të pezullojmë menjëherë të drejtën tuaj të hyrjes, pa përgjegjësi apo njoftim paraprak, për çfarëdo arsye, duke përfshirë pa asnjë kufizim rastin kur Ju do të shkelni këto Kushte.

Me mbarimin e të drejtës së hyrjes, do të pushojë menjëherë e drejta juaj e përdorimit të Shërbimit.

Kufizimi i Përgjegjësisë

Pavarësisht dëmeve që mund të shkaktoni Ju, e gjithë përgjegjësia e Shoqërisë dhe e Shërbimofruesve të saj e përcaktuar nga këto Kushte dhe mjeti juridik kompensues i juaj ekskluziv për gjithçka u tha më lart do të kufizohet tek shuma faktikisht e paguar nga Ju nëpërmjet Shërbimit. Nëse nuk keni blerë asgjë nëpërmjet Shërbimit, atëherë Shoqëria dhe shërbimofruesit e saj nuk do të mbajnë asnjë përgjegjësi në asnjë rrethanë kundrejt Jush.

Në masën maksimale të lejuar nga ligji në fuqi, në asnjë rast Shoqëria apo shërbimofruesit e saj nuk do të jenë përgjegjës për asnjë dëm tërthortë ose rastësor (duke përfshirë por pa u kufizuar në dëmshpërblimin për humbje të fitimeve, humbje të të dhënave apo informacioni tjetër, për ndërprerjen e biznesit, për lëndim fizik, humbje të privatësisë që lind nga ose në ndonjë mënyrë që lidhet me përdorimin e ose pamundësinë e përdorimit të Shërbimit, programe kompjuterike të palëve të treta dhe/ose pajisje kompjuterike të palëve të treta të përdorura me Shërbimin, ose që kanë lidhje me përcaktimet e këtyre Kushteve), edhe sikur Shoqëria apo shërbimofruesit të jenë këshilluar për mundësinë e këtyre dëmeve dhe edhe sikur mjeti juridik kompensues nuk e arrin qëllimin për të cilin përdoret. Ka risqe që lidhen me të gjitha aktivitetet fizike, duke përfshirë ecjet e gjata në këmbë, çiklizmin malor, fluturimin e lirë me vela, fluturimin me motor trirrotësh me vela, balonat me ajër të nxehtë, vizitat në kanione, alpinizmin, aktivitetet në ujë, joga, etj. Duke marrë pjesë në aktivitete, workshop-e, apo evente të tjera të çfarëdolloj natyre në South Outdoor Festival, ju deklaroni se jeni në gjendje fizike të optimale dhe nuk keni asnjë gjendje mjekësore që do të pengonte pjesëmarrjen tuaj në aktivitete të tilla. Ju pranoni dhe merrni përsipër të gjitha risqet e lëndimeve apo dëmtimeve nga aktivitete të tilla të natyrave të ndryshme, për cilindo shkak, të njohur apo të panjohur; dhe me dijeninë dhe vullnetin tuaj të lirë hiqni dorë nga pretendimet kundër South Outdoor Festival dhe Shërbimofruesit e tij, si dhe punonjësit, vullnetarët, instruktorët dhe përfaqësuesit, si dhe Shoqëria dhe Shërbimofruesit nuk do të mbajnë përgjegjësi për lëndime apo dëmtime që mund të pësoni ju si rezultat i pjesëmarrjes në këto aktivitete të cilësdo natyre, për cilindo shkak.

Shoqëria nuk është përgjegjëse për lëvrimin e Mallrave nga Shërbimofruesit. E gjithë përgjegjësia për lëvrimin e Mallrave është e Shërbimofruesve. Duke hyrë në ose duke përdorur Shërbimin, Ju kuptoni dhe bini dakord se nuk do të ngrini asnjë pretendim ligjor dhe/ose financiar kundër Shoqërisë në lidhje me Mallrat e lëvruara nga Shërbimofruesit ose në përputhje me këto Mallra dhe se këto pretendime duhet t'i bëhen direkt Shërbimofruesve. Shoqëria nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi përsa i takon pretendimit (financiar dhe ligjor) nga Ju/vizitorët në lidhje me Mallrat e lëvruara nga Shërbimofruesit.

Në South Outdoor Festival dhe në aktivitetet e ofruara gjatë festivalit nuk lejohet asnjë nga të mëposhtmet: substanca të paligjshme, droga, armë të çfarëdo lloji, përfshirë, por pa u kufizuar në, thika xhepi ose lëndë lotsjellëse për vetëmbrojtje

me sprucim, lëngje ose artikuj të ndezshëm, përfshirë aerosole dhe fishekzjarre. Organizatorët e South Outdoor Festival dhe shërbimofruesit tanë nuk do të mbajnë përgjegjësi për çdo humbje, dëmtim ose lëndim që mund të ndodhë në këtë aktivitet si rezultat i artikujve të tillë. Shoqëria rezervon të drejtën t'i kërkojë një pjesëmarrësi të largohet nga festivali nëse sjellja e tij/saj konsiderohet e papërshtatshme ose perceptohet si kërcënim për sigurinë dhe mirëqenien e aktivitetit. Ambientin duhet ta mbani të pastër.

Përgjashtimi nga Përgjegjësia për Shërbimet "SIÇ JANË" dhe "SIPAS DISPONUESHMËRISË"

Shërbimi ju ofrohet për Shërbimet "SIÇ JANË" dhe "SIPAS DISPONUESHMËRISË" dhe me të gjitha gabimet dhe defektet pa ndonjë garanci të ndonjë lloji. Në masën maksimale të lejuar nga ligji në fuqi, Shoqëria, në emër të saj, në emër të anëtarëve të saj dhe licencuesve dhe shërbimofruesve të tyre përkatës, heq dorë shprehimisht nga të gjitha garancitë, qofshin ato të shprehura, të nënkuptuara, statutore ose të tjera, në lidhje me Shërbimin, duke përfshirë të gjitha garancitë e nënkuptuara të tregtueshmërisë, përshtatshmërinë për një qëllim të veçantë, titullin dhe mos-shkeljen, dhe garancitë që mund të lindin për shkak të trajtimit, gjatë performancës, përdorimit ose praktikës tregtare. Pa kufizime për sa më sipër, Shoqëria nuk ofron asnjë garanci ose sipërmarrje, dhe nuk bën asnjë deklaram të ndonjë lloji se Shërbimi do të përmbushë kërkesat tuaja, do të arrijë ndonjë rezultat të synuar, do të jetë i pajtueshëm ose do të funksionojë me ndonjë program kompjuterik tjetër, aplikacione, sisteme ose shërbime, do të funksionojë pa ndërprerje, do të përmbushë çdo standard të performancës ose qëndrueshmërisë ose do të jetë pa gabime ose që mund ose do të korrigjohen gabimet ose defektet.

Pa u kufizuar nga sa më sipër, as shoqëria dhe as ndonjë nga shërbimofruesit e saj nuk bën asnjë deklaram ose garanci të ndonjë lloji, të shprehur ose të nënkuptuar: (i) sa i përket funksionimit ose disponueshmërisë së Shërbimit, ose informacionit, përmbajtjes, materialeve ose produkteve të përfshira në të; (ii) se Shërbimi do të jetë i pandërprerë ose pa gabime; (iii) për sa i përket saktësisë, qëndrueshmërisë ose përditshmërisë së çdo informacioni ose përmbajtjeje të dhënë përmes Shërbimit; ose (iv) se Shërbimi, serverët e tij, përmbajtja ose mesazhet e postës elektronike të dërguara nga ose në emër të Shoqërisë do të jenë pa viruse, gjuhë kompjuterike, kode kompjuterike të dëmshme, programe kompjuterike të dëmshme si "worms, malware, time bombs" ose elementë të tjerë të dëmshëm.

Sigurimet

Shoqëria nuk ka dhe nuk do të ketë, dhe nuk ka mbajtur siguracion kundër të gjitha rreziqeve kundër të cilave zakonisht sigurohen shoqëritë që kryejnë biznes dhe/ose aktivitete të ngjashme, për zëvendësimin e plotë ose vlerën e rikthimit të biznesit dhe asetëve dhe në veçanti nuk ka pasur sigurimin e kërkuar me ligj, sigurimin për përgjegjësinë e produktit dhe të dëmshpërblimit profesional, për arsyen se ajo vepron si ndërmjetëse dhe nuk i ofron Mallrat vetë por Mallrat ofrohen nga palë të treta.

South Outdoor Festival nuk iu ofron Juve apo klientit/pjesëmarrësit ndonjë siguracion, as jete, as udhëtimi, as mjekësor apo për përgjegjësinë, për ndonjë sëmundje, aksident, lëndim, humbje ose dëmtim që mund të lindë në lidhje me pjesëmarrjen ose frekuentimin e SOF, duke përfshirë por pa u kufizuar tek aktivitetet e lidhura me të. Nëse dëshirohet ndonjë siguracion personal i ndonjë lloji, kjo është fakultative dhe Ju ose klienti/pjesëmarrësi mund ta marrë atë vetë. Kostot e siguracionit, të gjitha shpenzimet dhe incidentet të pa përmendura më lart janë përgjegjësia Juaj dhe e klientit/pjesëmarrësit në secilën dhe të gjitha aktivitetet e lidhura me SOF. Në rast se Ju ose klienti/pjesëmarrësi nuk zgjedh të marrë pjesë në ndonjë apo të gjitha aktivitetet që bëjnë pjesë të SOF, Juve ose klientëve/pjesëmarrësve nuk do t'ju ofrohet kompensim shtesë në shkëmbim dhe nuk do të ketë rimbursime. Krahas kësaj, Ju ose klienti/pjesëmarrësi garanton se nuk ka dijeni për ndonjë gjendje mjekësore të mëparshme apo lëndime që mund t'ju rrezikojnë Ju dhe/ose klientët/pjesëmarrësit nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitetet e SOF ose, nëse Ju dhe/ose klientët/pjesëmarrësit keni gjendje mjekësore ose lëndime të tilla, atëherë Ju dhe/ose klientët/pjesëmarrësit merrni përsipër të njoftoni me shkrim Shoqërinë dhe Shërbimofruesit përpara pjesëmarrjes në aktivitete në mënyrë që South Outdoor Festival të mund të përcaktojë nëse (në diskrecionin e tij) klienti/pjesëmarrësi mund të marrë pjesë ose jo.

Ligji në Fuqi

Këto Kushte dhe përdorimi Juaj i Shërbimit do të rregullohen nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar rregullat e tij për konfliktet ndërmjet ligjeve.

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Nëse keni ndonjë shqetësim apo mosmarrëveshje në lidhje me Shërbimin, Ju bini dakord të përpiqeni në fillim ta zgjidhni mosmarrëveshjen jo zyrtarisht duke kontaktuar Shoqërinë. Në rast se diskutimet jo zyrtare nuk do të japin rezultat, gjykata kompetente për pretendimet do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pajtueshmëria Ligjore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Ju deklaroni dhe garantoni se (i) nuk jeni i vendosur në një vend që i nënshtrohet embargos së qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose që është përcaktuar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si një vend “mbështetës i terrorizmit”, dhe (ii) Ju nuk jeni i përfshirë në ndonjë listë të qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës me palë të ndaluara ose kufizuara.

Pavlefshmëria e Pjesshme dhe Dorëheqja

Pavlefshmëria e Pjesshme

Nëse ndonjë dispozitë e këtyre Kushteve konsiderohet e pa zbatueshme ose e pavlefshme, ajo dispozitë do të ndryshohet dhe interpretohet për të përmbushur objektivat e asaj dispozite në masën më të madhe të mundshme sipas ligjit në fuqi dhe dispozitat e mbetura do të vazhdojnë në fuqi dhe efekt të plotë.

Dorëheqja

Pëveçse siç është parashikuar në këtë dokument, mosrespektimi i një të drejte ose moskërkimi i përmbushjes së një detyrimi në bazë të këtyre kushteve nuk do të ndikojë në aftësinë e një pale për të ushtruar një të drejtë të tillë ose të kërkojë një përmbushje të tillë në çdo kohë më pas, e as një dorëheqje nga një shkelje nuk do të përbëjë dorëheqje nga çdo shkelje e mëvonshme.

Përkthimi

Këto Kushte janë përkthyer në shqip dhe Ne i kemi bërë të disponueshme për Ju në Shërbimin tonë.

Ju bini dakord që mbizotërues në rast mosmarrëveshjeje do të jetë teksti origjinal në anglisht.

Ndryshimet e Këtyre Kushteve

Ne rezervojmë të drejtën, në discrecionin tonë të vetëm, të ndryshojmë ose të zëvendësojmë këto Kushte në çdo kohë. Nëse një rishikim i tyre është thelbësor, Ne do të bëjmë përpjekje të arsyeshme të bëjmë njoftim të paktën 30 ditor përpara hyrjes në fuqi të kushteve të reja. Ajo që përbën ndryshim thelbësor do të përcaktohet vetëm nga discrecioni jonë.

Duke vazhduar të hyni ose të përdorni Shërbimin Tonë pas hyrjes në fuqi të këtyre rishikimeve, Ju bini dakord të jeni të detyruar nga kushtet e rishikuara. Nëse Ju nuk bini dakord me kushtet e reja, tërësisht ose pjesërisht, ju lutem mos e përdorni më faqen e Internetit dhe Shërbimin.

Na Kontaktoni

Nëse keni ndonjë pyetje për këto Kushte, Ju mund të na kontaktoni:

Nëpërmjet e-mail: hello@southoutdoor.al